



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 18 qershor, Paneli i Gjykatës Kushtetuese miratoi, si përjashtim, një kërkesë të Mbrojtjes së Viktimave për të dorëzuar parashtrime lidhur me kërkesën referuese të Pjetër Shalës në Gjykatën Kushtetuese të Dhomave të Specializuara, për një nga ankesat e paraqitura në të. Parashtrimi mund të ketë deri në tetë faqe dhe duhet të dorëzohet deri më 26 qershor.

Dhoma gjithashtu lejoi Pjetër Shalën t'i përgjigjet parashtrimin deri më 10 korrik, nëse dëshiron. Përgjigjja e z. Shala mund të jetë deri në 10 faqe në qoftë se do t'i trajtojë parashtrimet e Mbrojtjes së Viktimave dhe të Prokurorisë në dokumente më vete, ose deri në 15 faqe në qoftë se do të dorëzojë një përgjigje të përbashkët për të dyja.

Dhoma e Gjykatës Kushtetuese theksoi se ky vendim nuk ndikon vlerësimin që do t'i bëhet pranueshmërisë ose themelësisë së ankesës në fjalë, apo kërkesës referuese në tërësi.

Më 23 qershor, Kryetare Ekaterina Trendafilova miratoi pjesërisht një kërkesë të z. Haxhi Shala, i cili kishte kërkuar leje të përditësonte letërnjoftimin dhe dokumentet e udhëtimit të tij që u kishte kaluar afati, për të shkuar në Shqipëri për një pushim të shkurtër.

Në dhjetor 2024, z. Shala u vetëdeklarua fajtor për frikësim gjatë procesit penal dhe u dënua me tre vjet burgim. Pasi kreu dy të tretat e dënimit, Kryetarja Trendafilova urdhëroi lirin e tij me kusht në Kosovë për pjesën e mbetur të dënimit.

Në vendimin e saj, Kryetarja vlerësoi se personat duhet të kenë dokumente identifikimi të vlefshme dhe të përditësuara dhe urdhëroi Zyrën Administrative t'ia kthente dokumentet e identifikimit z. Shala për përditësimin e tyre. Kryetarja urdhëroi më tej z. Shala që dokumentet e përditësuara të udhëtimit t'ia kthejë Zyrës Administrative, sapo t'i marrë.

Sidoqoftë, Kryetarja vlerësoi se kërkesa e z. Shala për të shkuar në Shqipëri për pushime është tërësisht në kundërshtim me dënimin e dhënë, duke theksuar se lirimi me kusht nuk duhet të ndërpritet, përveç nëse është për arsye ligjore apo humanitare bindëse.

Ajo konstatoi më tej se pushimi i shkurtër do të cenonte integritetin e dënimit, do të ulte besimin e publikut në administrimin e drejtësisë dhe do të vinte në pikëpyetje natyrën e rëndë të veprave penale për të cilat u dha dënimi. Kryetarja i rikujtoi Z. Shala se duhet të respektojë kushtet që janë vendosur për lirin e tij në Kosovë për pjesën e mbetur të dënimit.

